



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 255/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren, për shkak të ofrimit të mitos për blerjen e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren

Arsyetim

PZAP-i, më datë 08.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK dega në Prizren, me të cilën pretendohet se aktivistët e PDK-së kanë vërejtur se në qytetin e Prizrenit konkretisht në vendvotimin në shkollën fillore “Fadil Hisari”, Florent Uka djali i Xhavit Ukajt - kandidati për deputet nga subjekti politik LDK bashkë me një grup të mbështetësve të këtij subjekti politik, ju ka ofruar qytetarëve mito në këmbim të votës. Parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik LDK ka bërë shkelje e nenit 33 pika f) të Ligjit për Zgjedhjet e Pergjithshme në Kosovë.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi informata më të hollësishme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës me nr. 2014/1-602-2 theksohet se gjatë ditës së zgjedhjeve në QV 2006a në shkollën “Fadil Hisari” në Prizren Policia e Kosovës ka pasur të caktuar pesë zyrtar policor, në krye me rreshterin Bashkim Luzhën si përgjegjës për atë qendër të votimit, e ku nga asnjë njësit i policisë dhe as nga rreshteri përgjegjës në këtë QV, nuk është pranuar apo nuk është raportuar për ndonjë parregullsi, apo për ndonjë ankesë lidhur me tentimin për blerje votash.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën si dhe shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk janë ofruar prova të mjaftueshme për vërtetimin e pretendimeve ankimore. Për më tepër, nga raporti i policisë me nr. 2014/1-602-2 rezulton se gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve nga personi përgjegjës i policisë së Kosovës dhe nga personat tjerë të këtij njësi nuk është vërejtur dhe nuk është raportuar për ndonjë parregullsi apo për ndonjë tentim për blerje të votave nga dikush, prandaj mbi këtë bazë, PZAP-i gjeti se është i pa bazuar pretendimi ankimor se në vendvotimin në shkollën fillore “Fadil Hisari”, Florent Uka djali i Xhavit Ukajt - kandidati për deputet nga subjekti politik LDK bashkë me një grup të mbështetësve të këtij subjekti politik, ju ka ofruar qytetarëve mito në këmbim të votave. Andaj PZAP-i vendosi se një pretendim i tillë ankimor është i pa argumentuar dhe i pa bazuar në fakte dhe prova bindëse.

Për arsyet e lartë përmendura, e në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 255/2014 më datën 11.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*